



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 12 (827710)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 19 Mars 2021

Gjeneralmajor Bajram Begaj:



Modernizim i armatimit luftarak në Batalionin e Mbështetjes me Luftim

Në kuadër të ristrukturimit të Forcës Tokësore, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj mori pjesë në mjediset e Repartit Ushtarak 1060, më 12 mars 2021, në ceremoninë e rreshtimit organik të Batalionit të Mbështetjes me Luftim. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe drejtori i Shtabit të Përgjithshëm kolonel Bilbil Bitri, komandanti i Forcës Tokësore

gjeneral brigade Arben Kingji dhe komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale kolonel Arben Zani. Gjatë fjalës së tij përshëndetëse, gjeneralmajor Begaj u shpreh se organizimi i Forcave të Armatosura synon jo vetëm rritjen e efikasitetit operacionale, por edhe një reformim të mëtejshëm të forcës ushtarake të vendit, bazuar edhe në mësimet e... >>> faqe 2

Model i gruas nën uniformë

"Të lë gjurmën time në udhëtimin ushtarak"

Intervistë me tetar Irida Hyka, instruktore për "Rregulloren dhe Disiplinën" në kursin e parë Bachelor në AFA



>>> faqe 4

Njohja me sfidat e së ardhmes së Forcave Ajrore të NATO-s

Kolonel Ylli Pulaj në takimin e komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s

Konferenca u zhvillua nën drejtimin e Jeffrey L. Harrigian, komandant i Forcave Ajrore të NATO-s dhe komandant i Forcave Ajrore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën >>> faqe 3



Stërvitja "Defender Europe 21"

Gjeneralmajor Mohan në mjediset e Komandës së Forcës Detare

Në kuadër të zhvillimit të stërvitjes së përbashkët "Defender Europe 21" gjeneralmajor Christopher O. Mohan, komandanti i Komandës Mbështetëse të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, zhvilloi një vizitë njohëse në mjediset e Komandës së Forcës Detare. Në këtë vizitë njohëse ishte i pranishëm shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Bajram Begaj. Gjeneralmajor Mohan...



>>> faqe 5

Qendra Stërvitore Pashaliman

Përfundon kursi Bazë i Nënoficerit për specialitetin Detari

Në mjediset e Qendrës Stërvitore Pashaliman, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Nënoficerit me specialitet Detari, i cili zgjati 8 javë. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe komandanti i Flotiljes Detare, kapiteni rangut të dytë Sabri Gjinollari. Komandanti i Qendrës Stërvitore Pashaliman, kapiteni rangut të dytë Bamir Likaj, personelit të sapo certifikuar... >>> faqe 5

Sfidat e sigurisë nuk janë zhdukur

Sekretari i Përgjithshëm paraqet Raportin Vjetor për vitin 2020

MSC. MIMOZA GOLIKJA

>>> faqe 8

PROJEKTI 7 VJEÇAR I SHËRBIMIT HIDROGRAFIK

Norvegjezët modernizojnë Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake

HAJRIE DEDAJ

>>> faqe 6

KOMANDA MBËSHTETËSE

Pozicione të lira pune: teknik armatimi, shofer dhe elektrikist

>>> faqe 7





Batalioni i Mbështetjes me Luftim krijon një kapacitet ushtarak të veçantë me një mision dhe detyra specifike për mbështetjen me zjarr, operacione xheniere dhe mbrojtje nga armët e dëmtimit në masë të reparteve të manovrës së Forcës Tokësore.

GJENERALMAJOR BAJRAM BEGAJ:

Modernizim i armatimit luftarak në Batalionin e Mbështetjes me Luftim

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH mori pjesë në rreshtimin organik të Batalionit të Mbështetjes me Luftim të Forcës Tokësore

Në kuadër të ristrukturimit të Forcës Tokësore, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj mori pjesë në mjediset e Repartit Ushtarak 1060, më 12 mars 2021, në ceremoninë e rreshtimit organik të Batalionit të Mbështetjes me Luftim.

Në këtë aktivitet morën pjesë edhe drejtori i Shtabit të Përgjithshëm kolonel Bilbil Bitri, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji dhe komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale kolonel Arben Zani.

Gjatë fjalës së tij përshëndetëse, gjeneralmajor Begaj u shpreh se organizimi i Forcave të Armatosura synon jo vetëm rritjen e efikasitetit operacionale, por edhe një reformim të mëtejshëm të forcës ushtarake të vendit, bazuar edhe në mësimet e nxjerra si vend anëtar i Aleancës së NATO-s dhe kontribues në misionet e operacionet e saj. "Shtabi i Përgjithshëm synon vijimin e punës për modernizimin e teknikës dhe armatimit luftarak të Batalionit të Mbështetjes me Luftim. Tashmë, efektivë të Kompanisë së Xhenios kanë filluar kurset EOD, duke synuar krijimin e kësaj ekspertize edhe brenda Forcës Tokësore, me qëllim mbështetjen e misionit të saj, si dhe kontributin e mundshëm përtej kufijve të Shqipërisë në të ardhmen...", theksoi gjeneralmajor Begaj.

Në përmblyllje të ceremonisë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, siguroi komandantin e Batalionit të Mbështetjes me Luftim, kolonel Petrit Dajlanin dhe efektivet e batalionit, për mbështetjen e tij dhe Shtabit të Përgjithshëm në arritjen



e standarteve dhe objektivave të caktuara. Komandanti i Batalionit të Mbështetjes me Luftim, kolonel Petrit Dajlani, falënderoi shefin e Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantin e Forcës Tokësore për praninë e tyre

në këtë ceremoni. Ai garantoj se do të jetë gjithmonë në krye të punës dhe sfidave që koha do të sjellë për Batalionin e Mbështetjes me Luftim.

Batalioni i Mbështetjes me Luftim krijon një kapacitet ushtarak të

veçantë me një mision dhe detyra specifike për mbështetjen me zjarr, operacione xheniere dhe mbrojtje nga armët e dëmtimit në masë të reparteve të manovrës së Forcës Tokësore. Në përfundim të ceremonisë shefi i

Shtabit të Përgjithshëm dhe të ftuarit ndoqën nga afër një demonstrim të përgatitur nga efektivet e këtij batalioni.

Në këtë aktivitet morën pjesë edhe drejtori i Shtabit të Përgjithshëm kolonel Bilbil Bitri, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji dhe komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale kolonel Arben Zani.

Gjatë fjalës së tij përshëndetëse, gjeneralmajor Begaj u shpreh se organizimi i Forcave të Armatosura synon jo vetëm rritjen e efikasitetit operacionale, por edhe një reformim të mëtejshëm të forcës ushtarake të vendit, bazuar edhe në mësimet e nxjerra si vend anëtar i Aleancës së NATO-s dhe kontribues në misionet e operacionet e saj. "Shtabi i Përgjithshëm synon vijimin e punës për modernizimin e teknikës dhe armatimit luftarak të Batalionit të Mbështetjes me Luftim. Tashmë, efektivë të Kompanisë së Xhenios kanë filluar kurset EOD, duke synuar krijimin e kësaj ekspertize edhe brenda Forcës Tokësore, me qëllim mbështetjen e misionit të saj, si dhe kontributin e mundshëm përtej kufijve të Shqipërisë në të ardhmen...", - theksoi gjeneralmajor Begaj.

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**
Hajrie **DEDAJ**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Njohja me sfidat e së ardhmes së Forcave Ajrore të NATO-s

Kolonel Ylli Pulaj në takimin e komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s

Konferenca u zhvillua nën drejtimin e Jeffrey L. Harrigian, komandant i Forcave Ajrore të NATO-s dhe komandant i Forcave Ajrore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj, mori pjesë në takimin e komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s, "NATO Air Chiefs' Symposium (NACS) 2021", i cili u zhvillua me video-konferencë. Ky ishte takimi i parë i komandantëve të Forcave Ajrore të vendeve të NATO-s dhe vendeve partnere për vitin 2021, ku morën pjesë 30 shefa të Forcave Ajrore.

Konferenca nga Ramstein, Gjermani, u zhvillua nën drejtimin e gjeneral Jeffrey L. Harrigian, komandant i Forcave Ajrore të NATO-s dhe komandant i Forcave Ajrore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën dhe kishte si qëllim diskutimin mbi situatën aktuale të sigurisë dhe mbrojtjes, njohja me sfidat e së ardhmes së Forcave Ajrore të NATO-s.

Takimi i Komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s, është një aktivitet periodik, i organizuar nga Komanda Ajrore e Aleancës, Ramstein, Gjermani, i cili zhvillohet në kuadër të takimeve vjetore të komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve nga strukturat e NATO-s, që ndjekin çështjet e Forcave Ajrore si Agjencia e Komunikimit e NATO-s (NCIA) dhe Qendrat e Operacioneve Ajrore të Kombinuara (CAOC). Takimi u përshëndet edhe nga Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Marshalli Sir Stuart Peach, i cili mbajti fjalimin kryesor mbi NATO-2030, "Përshtatja dhe Sfidat e së Ardhmes".

Gjeneral Jeffrey L. Harrigian, komandant i Forcave Ajrore të NATO-s dhe komandant i Forcave Ajrore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, tha se: "Këtë vit, ne po punojmë shumë për rritjen e Qendrës Hapësinore të NATO-s, avancimin e aktiviteteve të përbashkëta të trajnimit dhe sinkronizimin e ndarjes së inteligjencës për të konkurruar me kundërshtarët tanë. Duke parë nga e ardhmja, siguria e Aleancës kërkon përpjekje të mëtejshme inovative, si modernizimin e arkitekturës taktike të lidhjes së të dhënave të Aleancës dhe punën për ofrimin e trajnimeve reale të kundërshtarëve të drejtpërdrejtë". shtoi gjenerali Harrigian.

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Marshalli Sir Stuart Peach tha se: "Ky vit shënon gjashtëdhjetë vjet, që NATO realizon misione të policimit ajror për të mbajtur qiellin tonë të sigurt. Ne jemi duke investuar në të ardhmen përmes blerjes së Sistemit të Mbrojtjes Tokësore, modernizimin e flotës të avionëve të Sistemit të Paralajmërimit dhe Kontrollit Ajror dhe blerjen e kapacitetit satelitor me vlerë mbi 1 miliard euro në 2020-2034".

Pjesëmarrësit diskutuan mbi aktivitetet e Zbatimit të Hapësinorës së NATO-s me theks të veçantë koordinimin operacional



të aseteve hapësinore Aleate. Për më tepër, diskutimet përfshinin iniciativat shumëkombëshe që sigurojnë mbrojtjen e Zonës Euro-Atlantike duke përfshirë përparimin e vazhdueshëm

të integritit të avionëve të gjeneratës së katërt dhe të pestë, operacione dhe role të vazhdueshme të kontrollit ajror nga rritja e inventarëve të Aleatëve në teatrin Evropian.



NË MJEDISËT E KOMANDËS SË FORCËS AJRORE, RINAS

Profesionalizëm nga vajzat dhe gratë në strukturat e Forcës Ajrore

Zëvendëskomandanti i Forcave Ajrore, kolonel Ylli Pulaj takohet me përfaqësues të personelit femër në uniformë dhe ato civile, pjesë e strukturave të Forcës Ajrore në Garnizonin e Rinasit

Në mjediset e Komandës së Forcës Ajrore, Rinas, u zhvillua takimi i zëvendëskomandantit, kolonel Ylli Pulaj me përfaqësues të personelit femër në uniformë dhe ato civile të strukturave të Forcës Ajrore në Garnizonin e Rinasit.

Kolonel Pulaj, në fjalën e tij përshëndetëse, theksoi se ky takim njohës merr një vlerë të veçantë pasi realizohet menjëherë mbas ditës ndërkombëtare të grave dhe me këtë rast ai uroi të pranishmet për festën dhe falënderoi vajzat dhe gratë në uniformë duke përfshirë këtu edhe punonjëset civile për kontributin e tyre në Forcën Ajrore.

Gjithashtu zëvendëskomandanti,



ndërmjet të tjerash, përcolli mesazhin se prania dhe puna e vajzave e grave në uniformë dhe ato civile në strukturat e Forcës Ajrore është për t'u vlerësuar për korrektësinë, dedikimin dhe përkushtimin që ato tregojnë çdo ditë me profesionalizmin e tyre.

Në përfundim të fjalës së tij, kolonel Pulaj uroi shëndet për të gjithë vajzat e gratë në uniformë, punonjëset civile dhe familjet e tyre, pasi shëndeti, theksoi ai, merr rëndësi më shumë në këtë kohë pandemie si dhe në të njëjtën kohë i siguroi ato se, do të punojmë të gjithë së bashku për të përmbushur me sukses detyrat dhe për të çuar përpara Forcën Ajrore.

Model i gruas nën uniformë

“Të lë gjurmën time në udhëtimin ushtarak”

Intervistoi: MIMOZA GOLIKJA

Pas tetë javësh stërvitjeje intensive në QAPU Bunavi, kadetët e programit Bachelor janë rikthyer në Akademinë e Forcave të Armatosura. Programi mësimor “Studime në Shkenca Ushtarake” është program studimesh universitar i ciklit të parë, i organizuar në lëndë e module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Disiplinat mësimore dhe aktivitetet e tjera formuese janë të organizuara në pesë kategori lëndësh, ku bëjnë pjesë lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Veprimtaritë formuese, që janë pjesë e programit “Bachelor” në shkenca ushtarake, ndahen në mësim në auditor; përgatitje individuale; veprimtari të tjera formuese të lidhura ngushtë me profesionin e ushtarakut, të tilla si: përnjohje terreni, analizë beteje, stërvitje fushore, vizitë mësimore, fushim dimëror e veror, praktikë në trupa, etj. Në programin bachelor vazhdojnë ndjekjen e programit 58 studentë. Tetar Irida Hyka, është Instruktore për Rregulloren dhe Disiplinën në ciklin e parë të studimeve Bachelor, në AFA, në vitin akademik 2020-2021. Gazeta “Ushtria” e intervistoi tetar Irida Hykajn dhe sjell për lexuesit përvojën e saj.

Tetar Irida Hyka, ju keni filluar karrierën tuaj në FA në vitin 2011, si efektiv në kompaninë e ceremonialit, në batalionin e mbështetjes të SHPFA-së. Si u bëtë pjesë e FA-së? Cili është edukimi juaj bazë?

Kam lindur në Përmet, në shtator të vitit 1983 dhe shkollën e mesme të përgjithshme e kam kryer po atje. Më pas kam kryer studimet e larta në UBT, në Fakultetin Ekonomi dhe Agrobiznes, ku jam diplomuar në vitin 2009. Pasi u diplomova, dëshira ime ishte të bëhesha pjesë e Forcave të Armatosura dhe pas informacioneve që mora në vitin 2010 kam konkuruar për UP, ku dhe u shpalla fituese. Gëzimi im ishte i madh, por dhe krenaria në grupin tim shoqëror dhe në jetën civile. Isha shumë kurioze të dija për jetën e re që më priste dhe për punën e re që do të filloja. Në 1maj të vitit 2011, kam veshur për herë të parë Uniformën e FA-së. Emocion i papërshkruar, që nuk e kisha ndjerë më parë! Tashmë isha dhe unë një ushtarakë. E thënë ndryshe plotësiva dëshirën e madhe për t'u bërë pjesë e uniformës ushtarake.

Çfarë trajnimesh ushtarake të mëtejshme keni kryer? Cilat janë hapat që ju keni hedhur, derisa në tetor 2020 u bëtë pjesë e stafit të formimit ushtarak, në Akademinë e Forcave të Armatosura, në fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë?

Pasi u përfshiva në radhët e FA-së, në vitin 2011-2012 përfundova në Shkollën e Trupës Bunavi, të dy kurset SIA dhe SIB me rezultate të larta. Detyra ime e radhës pas titullimit UPII ishte në kompaninë e Ruajtjes së BM-SHP, përgjegjës skaner në Ministrinë e Mbrojtjes, ku kjo detyrë e rëndësishme ka vazhduar deri në fund të vitit 2014. Unë vazhdova me formimin tim të mëtejshëm profesional, me mundësitë që të ofrojnë Forcat e Armatosura kur bëhesh pjesë e tyre. Në fillim të vitit 2015 përfundova kursin institucional fillestar të Nënoficerit në Akademinë e Nënoficerave Thomson. Në atë kurs përgatiteshim për komandant grupi. Po në vitin 2015 bëra kërkesë për t'u bërë pjesë e ANO-së. Këtë herë jo si kursant po si Instruktor. Kërkesa ime u miratua

Intervistë me tetar Irida Hyka, instruktore për “Rregulloren dhe Disiplinën” në kursin e parë Bachelor në AFA

duke marrë parasysh edhe rezultatet e nxjerra në vijim dhe në përfundim të kursit.

Në formimin tim si Instruktor kanë ndikuar edhe eprorët apo kolegët të cilët duke marrë parasysh edhe dëshirën për të mësuar si vetë ashtu dhe të tjerët nuk e kanë reshtur kurrë ndihmën e tyre duke më mësuar dhe mbështetur në hapat që merrja në të mirë të programit mësimor dhe stërvitor.

Gjatë vitit 2017-2018 kam qënë në AFA, me detyrë administrator pranë zyrës së komandantit dhe në shtator të vitit 2017 kam kryer kursin bazë të Nënoficerit pjesa e parë Leadership, ndërsa në prill të 2018 kam kryer pjesën e dytë të kursit bazë, specialiteti këmbësori në Qendrën Stërvitore FT. Të jesh pjesë e Forcave të Armatosura do të thotë të jesh gjatë gjithë kohës në trajnim dhe stërvitje, të përvetësosh artin ushtarak dhe të ecësh nën gjurmët e më të mirëve, për të lënë edhe ti gjurmën tënde në këtë udhëtim të bukur dhe të vështirë. Të arsimohesh dhe stërvitesh është parësore, vlerësimi i eprorëve dhe pedagogëve të tu është gjithashtu, jo vetëm një tregues dhe stimul për ty, por edhe një shpërblim i djersës dhe sakrificës. Një ndër notat që më ‘prishte’ të gjithë biografinë e notave të tjera ishte 9-ta në përgatitje zjarri, ndërsa të pesë vlerësimet e tjera i kisha me notën 10. U rendita e para në kursin bazë të Nënoficerit. Pas mbarimit të kursit bazë, u emërova përsëri në ANO, Instruktor në kursin Bazë të N/of.

Në vitin 2018, në procesin e përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë të vitit 2018, bazuar mbi një sërë rubrikash, ku morën pjesë 72 nënoficerë, në përfundim sipas listë-meritës, ju u përzgjedhët nënoficer i



hëse ishin edhe vlerësimet vjetore të performancës së nënoficerëve. Pra përzgjedhja e Nënoficerit të vitit konsistonte me testimin e disa disiplinave, si testimi intelektual, testimi i gjuhës së huaj anglisht, marshim me ngarkesë 15-20 kg, 24 km, testim i përgatitjes fizike me të treja disiplinat, dhe prezantimi i një teme “Briefing”.

Do testoheshim 3 herë brenda një harku kohor 30 ditor. Një testim e bënte repartit, një testim tjetër me tre vendet e para e bënte forca dhe testimin e fundit e

numrit të femrave në konkurim, në një masë prej 20%.

Por edhe një vit më vonë në procesin e përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë për vitin 2019, duke ju referuar testeve dhe rezultateve përfundimtare sipas listë-meritës, bordi qendror i ngritur për këtë qëllim ju shpalli përsëri nënoficerin e vitit 2019. Çfarë do të thotë për ju ky vlerësim i dytë?

Po. Në vitin 2019, unë përjetova një tjetër emocion që ishte edhe më i madh se ai i një viti më parë. Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, u zhvillua procesi i përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë për vitin 2019. Në këtë proces konkurimi morën pjesë të gjithë nënoficerët me gradën N/tetar-Rreshter të të gjithë insitucioneve të vartësisë së KDS, AFA, ANO, SHT Bunavi, QS e QDK. Procesi i konkurimit përfshiu disa disiplina, si testimi intelektual, ai fizik, e gjuha e huaj. Duke ju referuar testeve dhe rezultateve përfundimtare sipas listë-meritës, bordi qendror i ngritur për këtë qëllim më shpalli përsëri nënoficerin e vitit 2019. Isha efektiv i ANO-së në atë kohë.

Aktualisht ju jeni instruktore e Rregullore dhe Disiplinës në ciklin e parë të studenteve Bachelor, në vitin akademik 2020-2021, në Akademinë e Forcave të Armatosura. Ku konsistojnë punat tuaja me kadetët?

Kam kryer detyrën e komanduar si Instruktor, në Kursin e Përgatitjes së Oficerit të Ri, më parë. Ky urdhër më erdhi papritur dhe ishte përzgjedhja e leadershipit të FA-së. E kam përjetuar me shumë emocion si dhe jam ndjerë shumë e vlerësuar atëherë. Jo vetëm për detyrën që m'u besua por dhe nga vetë

stafi që mërej me trajnimin e KPOR. Por ndërkohë kjo detyrë më bëri jo vetëm të “ndjehesha borxhlie” ndaj atyre njerëzve që më vlerësuan, por njëkohësisht dhe një detyrim moral për të dhënë më të mirën me korrektësinë, përkushtimin dhe seriozitetin që karakterizon një efektiv të FA-së. Pak kohë më vonë në mars të 2020 u bëra pjesë e Forcave Tokësore, në Bataljonin e Dytë të Këmbësorisë, me detyrë komandante skuadre tg3sk3. Ishte kërkesa ime si pasojë e dëshirës që kisha për ta përsosur akoma dhe më shumë specialitetin tim si këmbësor. Në atë batalion aq të rëndësishëm, jo vetëm për Forcat Tokësore, pata fatin të punoj me ushtarakë, vartës apo eprorë të cilët ishin të pa lodhur dhe tepër bashkëpunues, ku përveç angazhimit të madh stërvitor të përditshëm në fund të ditës merrje jo vetëm kënaqësinë për realizimin ditor të objektivave, por edhe vlerësimin e merituar. Pas këtij rrugëtimi në struktura të FA-së, në tetor të vitit 2020 më komunikuan urdhrin për emërim në Akademinë e Forcave të Armatosura. Nuk e prisja një vlerësim kaq të lartë, ashtu sikurse nuk e prisja të isha pjesë e këtij kursi që u hap për herë të parë. Puna ime konsiston në rregullin, disiplinën por edhe mesimdhënie në Rregulloret bazë ushtarake edhe Rregulloren rrjeshtore. Ndërkohë unë kam mbaruar pjesën e parë të kursit të avancuar në ANO, Leadership.

Cilat janë kushtet dhe kërkesat në respektim të masave anti-covid, të dala nga strukturat ushtarake, që ju zbatoni në përditshmërinë tuaj? E bën të vështirë kjo punën tuaj?

Në zbatim të protokolleve që dalin nga Ministria e Shëndetësisë, në aktualisht si forcë e armatosur zbatojmë “protokollin e masave shtrënguese” të nxjerrë nga ministri i Mbrojtjes dhe urdhrin e SHSHP-së, “për parandalimin e përhapjes së COVID-19”.

Patjetër që kushtet në cilat ndodhemi kërkohen më tepër përkushtim dhe kontrollë rigoroze, në mbajtjen e maskave, respektimin e distancave, ajrosjen dhe dezinfektimin e ambjenteve ku zhvillohet procesi mësimor/stërvitor. Absolutisht kërkohen më shumë impenjim por ja kemi dalë me sukses deri tani.

Kush janë synimet tuaja të mëtejshme të karrierës ushtarake?

Unë do të vazhdoj të shërbej me përkushtim dhe pasion në forcat e armatosura, me objektivin për t'u zhvilluar profesionalisht dhe për të avancuar në karrierë. Përtej objektivave të mia personale, unë dua që të përfaqësoj edhe modelin më të mirë të gruas nën uniformë, duke dhënë shembullin se edhe në gratë mundim! Shpresoj të bëj më të mirën me sinqeritet dhe pasion. Në përfundim dua të falënderoj të gjithë kolegët, vartësit dhe eprorët me të cilët kam punuar gjithë këto kohë, i falënderoj nga zemra për bashkëpunimin, ndihmën dhe mbështjen, dhe ju premtoj që nuk do t'i zhgënjëj në këtë rrugëtim sa të bukur aq dhe të vështirë.



vitet. Si u ndjetë?

Pothuajse në të gjitha aktivitetet që ka kryer FA, në kuadër të 28-29 Nëntorit, 5 garshin, Nënoficer i vitit etj., kam marrë gjithmonë pjesë, dhe sa herë që kam marrë pjesë në këto aktivitete unë kam zënë edhe vendet e para. Procesi i përzgjedhjes së nënoficerit më të mirë për vitin 2018 u realizua në një sërë rubrikash. Pjesë e kritereve përzgjed-

bënte Bordi, në rang të Forcave të Armatosura. Në këtë proces morën pjesë 72 nënoficerë nga grada e nëntetarit deri tek grada rreshter. Në përfundim sipas listë-meritës unë u përzgjedha si nënoficer i vitit. Risi nga vitet e kaluara, siç u shpreh dhe Bordi i Përzgjedhjes, ishte se në në procesin e këtij viti ishin përfshirja si kriter përzgjedhës edhe e elementit të marshimit në distancën që përmenda më lart, por edhe rritja e



Stërvitja "Defender Europe 21"

Gjeneralmajor Mohan në mjediset e Komandës së Forcës Detare

Komandanti i Komandës Mbështetëse të Forcave Tokësore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, gjeneralmajor Mohan është takuar me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj dhe ka zhvilluar një vizitë njohëse në mjediset e Batalionit të Xhenios

Në kuadër të zhvillimit të stërvitjes së përbashkët "Defender Europe 21" gjeneralmajor Christopher O. Mohan, komandanti i Komandës Mbështetëse të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, zhvilloi një vizitë njohëse në mjediset e Komandës së Forcës Detare. Në këtë vizitë njohëse ishte i pranishëm

shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Bajram Begaj. Gjeneralmajor Mohan në Komandën e Forcës Detare u prit nga komandanti, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia. Gjeneral brigade Xhebexhia i njohu të pranishmit me masat e marra nga Forca Detare në kuadër të stërvitjes "Defender Europe 21".

Më parë, në kuadër të masave

përgatitore për stërvitjen "Defender 21", Komandanti Komandës Mbështetëse të Forcave Tokësore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, gjeneralmajor Christopher O. Mohan është takuar me Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj dhe ka zhvilluar një vizitë njohëse në mjediset e Batalionit të Xhenios.

Në mjediset e Qendrës Stërvitore Pashaliman

Përfundon kursi Bazë i Nënoficerit për specialitetin Detari

Kursi Bazë i Nënoficerit me specialitet Detari ka zgjatur 8 javë



Në mjediset e Qendrës Stërvitore Pashaliman, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Nënoficerit me specialitet Detari, i cili zgjati 8 javë. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe komandanti i Flotiljes Detare, kapiteni rangut të dytë Sabri Gjinollari. Komandanti i Qendrës Stërvitore Pashaliman, kapiteni rangut të dytë Bamir Likaj, personelit të sapo certifikuar i uroi suksese dhe dijet e marra t'i përdorin në të ardhmen në repartet e tyre.

Faza e dytë pati gërshetim teorik, por kryesisht janë përqendruar në veprime praktike, të cilat u zhvilluan edhe në det, sipas detyrave që kryen ekuipazhi i anijeve të Forcës Detare.

Gjithashtu, pjesëmarrësit e këtij kursi u njohën gjerësisht me tema që përfshijnë njohjen e bregdetit shqiptar, sigurinë hidro-lundrimore, luftën kundër ujit dhe zjarrit në anije, shpëtimin e njeriut në det në kushte të ndryshme të motit dhe detit. Komandanti i kursit, instruktorët përkatës dhe pjesëtarët e Flotiljes Detare krijuan kushtet e nevojshme për zhvillimin normal të këtij kursi të rëndësishëm. Ceremonia u mbyll me shpërndarjen e certifikatave për të gjithë kursantët dhe një foto të përbashkët.



Pjesëmarrësit e këtij kursi u njohën gjerësisht me tema që përfshijnë njohjen e bregdetit shqiptar, sigurinë hidro-lundrimore, luftën kundër ujit dhe zjarrit në anije, shpëtimin e njeriut në det në kushte të ndryshme të motit dhe detit.

Efektivët e Forcës Tokësore dhurojnë gjak

Në kuadër të Fushatës së Dhurimit të Gjaku që ka filluar prej disa ditësh në Komandën e Forcës Tokësore, trupat e Batalionit të Dytë dhe Batalionit të Mbështetjes me Shërbime, i janë bashkuar kësaj nisme, si çdo vit.

Efektivët e Batalionit të Dytë, që në orët e para të mëngjesit kanë dhuruar gjak. Këta efektivë, të cilët i kanë qëndruar gjith-

monë në krah popullsisë civile në rastet e Emergjencave Civile edhe këtë herë treguan humanizmin e tyre duke dhuruar gjak për të shpëtuar jetë. Fushata e Dhurimit të Gjaku do të vazhdojë edhe në ditët në vijim, me reparte të tjera të Forcës Tokësore. Fushata kryhet në bashkëpunim me Bankën e Transfuzionit të Gjaku dhe nën kujdesin e mjekëve të Qendrës Shëndetësore të Forcës Tokësore.



Projekti 7 vjeçar i Shërbimit Hidrografik të Mbretërisë së Norvegjisë

HAJRIE DEDAJ

Në dhjetor të këtij viti përfundon mbështetja nga pala Norvegjeze për projektin e hartave detare. IGJIU ka planifikuar të realizojë aktualisht tre lloje hartash detare elektronike ENC, që janë të tipit Coastal (hartat që përfshijnë të gjithë ujërat detarë të vendit tonë) me shkallë 1:90000, hartat Approach (hartat e afërimit për në port) me shkallë 1:22000 dhe hartat Harbour (hartat portuale) me shkallë 1:4000. Deri më tani janë realizuar hartat Coastal dhe Approach dhe janë duke u realizuar hartat Harbour.

Pak fjalë për historikun e Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake

Punimet e para gjeodezike në Shqipëri zënë fill në vitet 1918-1927 me punimet e Institutit Gjeografik të Vjenës. Në përfundim të Luftës së Parë Botërore ky institut botoi 22 fletë harte të territorit të Shqipërisë në shk.1:75.000 të krijuara me metoda të drejtpërdrejta matjesh në terren. Në 17 shtator 1927 krijohet grupi i parë gjeodezik me 13 specialistë. Detyra e këtij shërbimi ishte plotësimi i nevojave të ushtrisë me harta dhe materiale hartografike, organizimi i përgatitjes topografike të ushtarakëve, sigurimi i bazamentit të nevojshëm gjeodezik për nevoja të ushtrisë etj. Instituti Topografik i Ushtrisë u krijua në 8 Mars të vitit 1975 me vendim të Këshillit të Ministrave, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, me qendër në Tiranë. Në këtë vendim përcaktohet se ITU është një institucion ushtarak, kërkimor e prodhues në fushën e përgatitjes gjeografike të ushtrisë shqiptare. Ai u krijua nga bashkimi i dy repartëve, repartit të Topografisë dhe ai i Hartografisë, të cilët kishin ushtruar aktivitetin e tyre, që nga dhjetori i vitit 1961. Në qershor të vitit 2012, IGJU kaloi në varësi të MM-së dhe në qershor të vitit 2014 me rastin e kalimit në strukturën e re organizative, IGJU bashkohet me ISPMb dhe merr emrin "Institutit të Gjeografisë dhe i Infrastrukturës Ushtarake". Krijimi dhe veprimtaria e ITU-së sot IGJIU,

Norvegjezët modernizojnë Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake



të ekonomisë kombëtare në fushat e gjeodezisë, hartografisë, fotogrametrisë dhe remonte-sensing. Gjatë gjithë viteve në "Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake" janë realizuar disa projekte të rëndësishme si ai i krijimit të Rrjetit të ri gjeodezik të Shqipërisë i cili përfundoi në vitin 1986 si dhe krijimi i Rrjetit të ri të nivelacionit shtetëror i cili përfundoi gjatë viteve 1971-1987. Vlen të përmendet dhe vepra e madhe që ka kryer Instituti Topografik i Ushtrisë në fushën e hartografisë, krijimi i hartave të shkallës 1:25.000. Një tjetër projekt madhor është ai i parametrave të Transformimit në vitin 2007, parametrat e transformimit të koordinatave nga sistemi shtetëror ALB 87 në sistemin global

Norvegjisë është më i rëndësishmi që IGJIU ka patur vitet e fundit.

Ky projekt ka filluar më 27.11.2014 me nënshkrimin e marrëveshjes dypalëshe në Tiranë nga Sekretari i Përgjithshëm i MM-së për Palën Shqiptare dhe Drejtori i Shërbimit Hidrografik Norvegjez për palën Norvegjeze. Ky projekt konsiston në ndihmën nga pala norvegjeze për rritjen e kapaciteteve të IGJIU-së dhe Shërbimit Hidrografik Shqiptar për krijimin e hartave detare elektronike ENC (Electronic Navigation Charts) dhe hartave detare në letër. Zbatimi i projektit ALNO-HIP ka filluar në periudhën shkurt-prill 2015 me realizimin e specifikimeve teknike të software-it dhe hardwareve, që do të bliheshin për realizim të projektit. Në muajin gusht 2015 është bërë instalimi i softwarit Teledyne CARIS dhe për një periudhë nga shtatori deri në dhjetor 2015 janë kryer trajnime për programin nga kompania fituese pranë ambienteve të IGJIU-së. Janë përpiluar ENC e hartës detare Approach të shkallës 1:22 000 AL400001, AL400002, AL400003 si dhe Coastal të shkallës 1:90000 AL300001, të projektit ALNO-HIP. Gjithashtu trajnime të tjera në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar nga personeli pranë zyrave të IGJIU-së, por edhe në Norvegji dhe Itali. Projekti është drejt përfundimit me palën Norvegjeze. Ky projekt me investimin rreth 1.2 milion euro, ka bërë të mundur rritjen e kapaciteteve me pajisje dhe programe kompjuterike moderne e bashkëkohore të standardeve ndërkombëtare.

Projekti ka bërë të mundur, që vendi ynë të ketë për herë të parë harta elektronike të navigimit ENC, të cilat janë në shitje për përdoruesit që nga janari 2019, por gjithashtu edhe pajisje dhe personel të trajnuar për të realizuar hartat detare, sipas standardeve ndërkombëtare të IHO-s (International Hydrographic Organization). IGJIU ka planifikuar të realizojë aktualisht

Projekti ka bërë të mundur që vendi ynë të ketë për herë të parë harta elektronike të navigimit ENC, të cilat janë në shitje për përdoruesit që nga janari 2019. Në dhjetor të këtij viti përfundon mbështetja nga pala Norvegjeze me vlerë 1.2 milionë euro për projektin e hartave detare. Ndërkohë vazhdon bashkëpunimi me Qendrën e Informacionit Gjeotopografik dhe Aeronautik të Italisë (CIGA) për krijimin e hartave ajrore shk.1:250.000.

tre lloje hartash detare elektronike ENC që janë të tipit Coastal (hartat që përfshijnë të gjithë ujërat detarë të vendit tonë) me shkallë 1:90000, hartat Approach (hartat e afërimit për në port) me shkallë 1:22000 dhe hartat Harbour (hartat portuale) me shkallë 1:4000. Deri më tani janë realizuar hartat Coastal dhe Approach dhe janë duke u realizuar hartat Harbour. Gjithashtu janë planifikuar që të realizohen edhe harta në letër të tipit Approach dhe Harbour.

Instituti shqiptar zotëron statusin e Agjencisë Hartografike Kombëtare në Shqipëri

Nëpërmjet sektorit të menaxhimit të arkivit, ofron shërbime për MM-në dhe SHPFA-në, Administratën Publike me material hartografik, fotografi ajrore, projekte inxhinierike, etj. Shërbimet që ofron IGJIU janë harta detare, harta tematike, harta topografike të standardeve të NATO-s. Fragmente të skanuara nga hartat e vjetra me rëndësi historike kombëtare të vërtetuara me origjinalin. Harta të Kufirit të hartuara nga Komisioni i Kufijve shk.1:50.000, v.1922-1925 Fragmente të skanuara nga fotografitë ajrore të vërtetuara me origjinalin. Fotografi ajrore të viteve '50-'60, fotografi ajrore të viteve '70-'90, fotografi ajrore të vitit 1994. Bashkëpunon me institucionet e linjës




Porti i Durrësit HARBOUR

Sipas institutit, në dhjetor të këtij viti përfundon mbështetja nga pala Norvegjeze për projektin e hartave detare. Aktualisht nuk ka bisedime për bashkëpunim tjetër me palën Norvegjeze për ndonjë projekt në lidhje me hartat ajrore apo tokësore, por instituti mbetet i hapur për mundësinë e një bashkëpunimi të tillë i cili do të ishte shumë ndihmues për IGJIU-në. IGJIU mbulon me harta gjithë ushtrinë, si pasojë Instituti zotëron statusin e Agjencisë Hartografike Kombëtare në Shqipëri, me përgjegjësinë e prodhimit të hartave tokësore, detare dhe ajrore, në shkallë të ndryshme. Gjithashtu është përgjegjës për hartimin e projekt/prevativave të zbatimit për projektet infrastrukturale të MM-së dhe SHPFA-së. Prodhon dhe mirëmban material hartografik në mbështetje të FA-së dhe institucioneve të administratës publike si dhe sistemit arsimor dhe biznesit.

përgjegjëse për informacionet në lidhje me zonat bregdetare të mbrojtura, zonat e ndaluara të peshkimit, zonat e parashikuara për ankorim si dhe të dhëna të tjera në mbështetje të hartave detare.

Bashkëpunim me Italinë (CIGA) për krijimin e hartave ajrore

Ndërsa Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake është në përfundim të projektit shtatëvjeçar me Norvegjezët për hartimin e hartave detare, aivijon bashkëpunimin me Qendrën e Informacionit Gjeotopografik dhe Aeronautik të Italisë (CIGA) për krijimin e hartave ajrore shk.1:250.000. Të gjithë projektet e lartpërmendur, që IGJIU ka realizuar ndër vite e bën atë të jetë një institucion i rëndësishëm jo vetëm për Forcat e Armatosura, por për të gjithë Republikën e Shqipërisë.



Porti i Durrësit APPROACH

janë pjesë e një mesazhi në ngritje, me përpjekje, me realizime, probleme studimore, zbatime e në reformim të vazhdueshëm.

Instituti i "Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake" të hënën, me 8 mars 2021, shënoi 46 vite të krijimit të tij. Ashtu si çdo institucion është përballur me vështirësi gjatë rrugëtimit, por ka arritur të përmbushë më së miri misionin e tij; mbështetjen gjeografike të veprimeve ushtarake të Forcave të Armatosura. Gjithashtu Instituti kryen veprimtari në mbështetje të zhvillimit

ETRF 2000.

Shërbimi Hidrografik i Mbretërisë së Norvegjisë më i rëndësishmi në projektin e hartave detare

Për një informacion më të detajuar dhe për tu njohur me ecurinë e projekteve vizituum ambientet e Institutit dhe kuptuam se bashkëpunimi për projektin ALNO-HIP (Albanian-Norwegian Hydrographic Information Project) me Shërbimin Hidrografik të Mbretërisë së

Komanda Mbështetëse

Pozicione të lira pune: teknik armatimi, shofer dhe elektrikist

Pozicionet e lira janë në repartet ushtarake 4009, 4007 dhe 4006. Afati i mbylljes së aplikimit për të interesuarit është 21.03.2021

Për teknikun e armatimit kontrata e punës është 3 mujore dhe mënyra e aplikimit është me dosje, institucioni është Reparti Ushtarak 4009, Komanda Mbështetëse, Tiranë. Për vend të lirë pune shofer kontrata e punës është 3 mujore dhe mënyra e aplikimit është me dosje, institucioni është Reparti Ushtarak 4007, Komanda Mbështetëse, Tiranë. Edhe për vendin e punës teknik mesëm, elektrikist, agregagist, kontrata e punës është 3 mujore dhe mënyra e aplikimit është me dosje, institucioni është Reparti Ushtarak 4006, Komanda Mbështetëse, Tiranë. Për të tre pozicionet e lira të mësipërme afati i mbylljes së aplikimit për të interesuarit është 21.03.2021. Për të tre pozicionet, aplikantët, specifiku, duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Njesisë së Personelit të Strukturës që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën (adresa postare e repartit/strukturës përkatëse).

Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme: kërkesën; formularin e aplikimit; fotokopje të kartës së identitetit; diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal; fotokopje të patentës; dëshmi profesioni nëse ka; certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja raport mjekësor; fotografi me përmasa 4x6, 2 copë; 9x12, 2 copë, dëshmi penaliteti; vërtetim nga gjykata; vërtetim nga prokuroria; librezë pune; jetëshkrimin (CV), formularin e vetëdeklarimit,

i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike eëë. mod.gov.al. (linku: Baza ligjore/ Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/ formulari i vetëdeklarimit).

Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës: të ketë shtetësinë shqiptare; të jetë jo më pak se 18 vjeç; të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar; të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara; të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore; të mos jetë të dënuar me

burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi; të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

Në kazemat “NH Strasho Pindzur”, në garnizonin Petrovec, u shënuar solemnisht: Dita e Komandës së Forcave Rezervë. Në ceremoni morën pjesë Shefi i Shtabit të Komandës Operative (CM), Gjeneral Brigade Mirce Gjorgoski dhe komandantët e njësisë në garnizonin Petrovec. Në fjalimin e tij, Komandanti i Komandës së Forcave Rezervë, kolonel Giro Kalkov tha se ata janë krenarë që janë bartës të traditave të kësaj ngjarje nga historia e afërt e popullit maqedonas, një ngjarje kur në kullën e vrojtimit “Ramna Niva” në Kriva Palanka, më 11 Mars 1992, për herë të parë, flamuri shtetëror u shpalos në kufirin shtetëror, duke kompletuar kështu integritetin territorial të vendit tonë dhe duke shënuar krijimin e Ushtrisë. Në fjalën e tij, Shefi i Shtabit, Gjeneral Brigade Mirce Gjorgoski, theksoi se në zhvillimin dhe formimin e komandave dhe njësisë të Ushtrisë, në pjesën e rezervës aktive dhe të përgjithshme, Komanda e Forcave Rezervë ka një vend veçanërisht të rëndësishëm. Me rastin e ditës së njësisë, anëtarëve të njësisë iu dhanë masa stimuluese për rezultatet e arritura në punë dhe në të njëjtën kohë u lexuan urimet.

Mjekët ushtarakë trajnohen nga Shërbimi Mjekësor Ushtarak Norvegjez

Atasheu i Mbrojtjes i Mbretërisë së Norvegjisë, Nënkolonel Egil Daltueit, është shprehur për mediat lidhur me ekipit kirurgjik maqedonas që po trajnohet aktualisht në Norvegji.

Nënkolonel Egil Daltueit, pohon se: “si një anëtare e NATO-s, Republika e Maqedonisë së Veriut është e angazhuar për rritjen e aftësive profesionale për veten dhe për aleancën. Kjo u diskutua nga ministrja e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut, dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm në një takim me Presidentin Pendarovski më 11 Shtator 2020. Një prej angazhimeve është rritja e aftësive të nevojshme nga ekipi i kirurgjisë në terren, ku u diskutua se si të zhvillohet kjo aftësi sipas standardeve më të larta të NATO-s. Më vonë, po atë ditë, ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska dhe gjenerali Vasko Gjurčinovski zyrtarisht ishin të interesuar nëse Mbretëria e Norvegjisë ishte e gatshme të trajnonte një ekip kirurgjik maqedonas dhe ta integronte atë në një spital për terren, të drejtuar nga Norvegjia në Kabul si pjesë e Operacionit “Mbështetje e Vendosur” në kuadër të Misionit të NATO-s në Afganistan.


Kjo u pranua nga ana jonë dhe ekipi mjekësor maqedonas arriti në

Norvegji më 15 janar 2021. Unë personalisht isha i pranishëm për t’i përshëndetur dhe mirëpritur ata së bashku me përfaqësuesit e Shërbimit të Përbashkët Mjekësor Ushtarak Norvegjez, drejtuesit e spitalit për terren dhe ambasadorin maqedonas në Mbretërinë e Norvegjisë. Përshtypja ime për secilin anëtar të ekipit bazuar në takimin tonë ishte shumë pozitive.

Pas detyrimit që të futeshin në karantinë dhjetë ditë pas mbërritjes në Norvegji, ekipi u trajnuar me homologët e tyre norvegjezë me të cilët do të vendosen së bashku në Afganistan. Trajnimi kryhet nga Shërbimi i Përbashkët Mjekësor Ushtarak Norvegjez, dhe metodologjia dhe cilësia e trajnimit janë të tilla që shumë prej aleatëve kryesorë të NATO-s deri më tani kanë dërguar dhe akoma dërgojnë ekipet e tyre në Norvegji për të marrë pjesë në këtë lloj trajnimi. Me pak fjalë, ata janë trajnuar nga ekspertë liderë të botës në kirurgjinë e traumës. Ekipi kirurgjik norvegjez me të cilin do të vendosen së bashku janë profesionistë të lartë të klasit botëror të mjekësisë.

Norvegjia ka pranuar detyrën për trajnimin e ekipit maqedonas bazuar në bashkëpunimin e ngushtë afatgjatë me forcat maqedonase të armatosura në fushën e mjekësisë ushtarake. Më parë, në shtatë raste, ekipet mjekësore maqedonase ishin vendosur me ne në Afganistan. Si një shembull i profesionalizmit të treguar nga stafi juaj, njërit prej mjekëve maqedonas iu nda një medalje prestigjioze norvegjeze për shpëtimin e jetës së ushtarëve norvegjezë të plagosur aq rëndë dhe për të cilët nuk kishte shumë shpresë për të mbijetuar. Është e natyrshme që një ekip i rekrutuar për të vendosur bazën e aftësive të ekupeve kirurgjikalë në terren në Forcat e Armatosura të Maqedonisë së Veriut, nuk është 100% i gatshëm në fillim të trajnimit. As skuadra norvegjeze nuk është 100% e gatshme, kështu që të dy ekipet kalojnë trajnim të përbashkët shumë kompleks. Gjatë trajnimit trajtojmë pjesëtarët tuaj, burra dhe gra, njëjtë si pjesëtarët tanë. Ne i kemi dhënë ekipit tuaj të njëjtat privilegje si ekipit tonë, përfshirë vaksinimin kundër Covid-19 për të gjithë këtë javë. Pas trajnimit, nuk është lëshuar

asnjë ankesë zyrtare nga pala norvegjeze kundër ndonjërit prej gjashtë pjesëtarëve të ekipit maqedonas, as kundër ekipit në tërësi. Sigurisht, gjatë trajnimit, janë identifikuar disa fusha për përmirësim në të dy ekipet, dhe në të gjithë individët. Sigurisht, janë dhënë udhëzime shumë të qarta në lidhje me fushat në të cilat kërkohet përmirësim. Si rezultat, pamë që anëtarët e ekipit tuaj i morën komentet me shumë seriozitet dhe punuan shumë për të arritur standardin botëror për të cilin insistojnë trajnuesit. Komandanti i spitalit për terren, nënkolonel Bent Anders Salberg dhe stafi i tij kanë besim të plotë në secilin anëtar të ekipit maqedonas dhe presin që të shërbejnë krah për krah me ta në këtë mision kompleks. Si komandant, ai do të caktojë detyra për të gjithë spitalin, duke përdorur secilin ekip dhe secilin individ në përputhje me aftësitë e tyre. Për më tepër, trajnimi dhe ndërtimi i përvojave në ekipin tuaj do të vazhdojë, pas të cilit ata do të kthehen në Maqedoninë e Veriut me aftësi që nuk i kishin më parë”.



Takimi diskutoi hapat e mëtejshëm për të forcuar ndërveprueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe gatishmërinë e anëtarëve të A5, si dhe të ardhmen e rajonit në drejtim të integritimit Euro-Atlantik dhe sfidave të sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Vuçiniç vuri në dukje se perspektivat europiane dhe euro-atlantike janë rruga e vetme e duhur për të ardhmen e rajonit.



KARTA SHBA-ADRIATIK (A5)

Bashkëpunim rajonal përmes stërvitjeve dhe trajnimeve të përbashkëta

Trajnimet e përbashkëta ushtarake do të kontribuojnë në forcimin e pjesëmarrjes së përbashkët në misionet ndërkombëtare

Brenda presidencës kroate të këtij viti, u mbajt më 13 mars 2021, përmes një lidhje video, takimi Kartës SHBA-Adriatik (A5) në nivelin e drejtorëve politikë të Ministrive të Mbrojtjes dhe Ministrive të Punëve të Jashtme të vendeve anëtare dhe vëzhguesve të Kartës SHBA-Adriatik. Mali i Zi u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për Politikën e Mbrojtjes dhe Planifikimit të Ministrisë së Mbrojtjes, gjeneralmajor Rajko Pesic dhe Drejtori i Përgjithshëm për NATO dhe Politikën e Sigurisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Vladimir Vucinic.

Takimi diskutoi hapat e mëtejshëm për të forcuar ndërveprueshmërinë, qëndrueshmërinë dhe gatishmërinë e anëtarëve të A5, si dhe të ardhmen e rajonit në drejtim të integritimit Euro-Atlantik dhe sfidave të sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Vuçiniç vuri në dukje se perspektivat europiane dhe euro-atlantike janë rruga e vetme e duhur për të ardhmen e rajonit. Në atë kontekst, ai theksoi se A5 është një shembull i një forumi të suksesshëm rajonal për promovimin e vlerave Euro-Atlantike dhe bashkëpunimin në Ballkanin Perëndimor. Kjo tregohet nga fakti që të gjithë anëtarët e A5, përveç Bosnje-Hercegovinës, janë bërë ndërkohë aleatë të NATO-s. Në këtë drejtim, Vucinic theksoi gatishmërinë e Malit të Zi për të siguruar mbështetje politike dhe praktike për



Bosnje-Hercegovinën, si dhe vendet e tjera në rajon, për të përmirësuar bashkëpunimin me NATO, brenda ambicieve të tyre kombëtare, dhe

për të avokuar për zgjerimin e anëtarësimit në A5 për përparimin e mëtejshëm të rajonit në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Euro-

pian dhe nevojave për mbështetje të ndërsjellë në mënyrë që të zbatohen reformat e nevojshme për të arritur perspektivën e përbashkët europiane sa më shpejt të jetë e mundur.

Lidhur me zhvillimet rajonale, Vucinic theksoi se pandemia aktuale dhe pasojat e saj kanë forcuar më tej nevojën për bashkëpunim midis anëtarëve të A5 dhe vëzhguesve. Ai falënderoi për ndihmën e vlefshme që Shtetet e Bashkuara japin për punën e A5. Gjenerali Pesic vuri në dukje se A5 provoi të ishte një mekanizëm i rëndësishëm për përmirësimin e bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor, si dhe afirmimin e vlerave të trashëguara nga Aleanca e Atlantikut të Veriut. Ai gjithashtu theksoi se një nga detyrat e rëndësishme të vendeve në rajon është forcimi i sistemeve të mbrojtjes kombëtare dhe se përpjekjet e ardhshme të Kartës duhet të synojnë arritjen e këtij qëllimi, përmes stërvitjeve dhe trajnimeve të përbashkëta ushtarake, të cilat gjithashtu do të kontribuojnë në forcimin e pjesë-

marrjes së përbashkët në misionet ndërkombëtare.

Pesic theksoi përvojën pozitive të kontributit të përbashkët në operacionet në Afganistan, brenda misionit "Mbështetja e Vërtetë" dhe vuri në dukje angazhimin e mundshëm të përbashkët brenda Kartës SHBA-Adriatik në misionet e ardhshme të NATO-s. Duke folur për sigurinë kibernetike, Gjenerali Pesic tha se kërcënimet kibernetike në rajon po bëhen më të shpeshta dhe komplekse, dhe se mënyra më efektive për t'iu kundërvënë atyre është veprimi dhe bashkëpunimi i përbashkët, i cili përfshin shkëmbimin në kohë të informacionit. Takimi miratoi Planin e Veprimit për presidencën e Republikës së Kroacisë në Kartën SHBA-Adriatik për 2021, i cili parashikon mirëmbajtjen e 24 aktiviteteve në një nivel të lartë dhe ekspert, që synojnë përmirësimin e bashkëpunimit politik dhe mbrojtës-ushtarak midis shteteve anëtare të Kartës.

MISIONI I BASHKIMIT EUROPIAN "EU NAVROR SOMALIA"

Fregata malazeze përfundoi angazhimin në misionin "Atalanta"

Detashmenti i katërt i Forcave Detare të Ushtrisë së Malit të Zi u kthye në Mal të Zi pas katër muajve të angazhimit të suksesshëm në operacionin detar të Bashkimit Europian "EU Navfor-Atalanta". Dymbëdhjetë anëtarë të ekipit, nën komandën e togerit të fregatës Lazar Knežić, gjatë misionit kanë realizuar shpërndarjen e sigurt të gati 2,000 tonë ushqime dhe ndihma të tjera për popullatën e Somalisë, nën kujdesin e Programit Botëror të Ushqimit të Kombeve të Bashkuara. Detyra e tyre ishte parandalimi, sigurimi dhe mbrojtja e anijes "Spikeroo" dhe ngarkesave nga sulmet e mundshme pirate, rrëmbimet ose grabitjet.

Bashkimi Europian formoi forcën detare "EU Navfor-Somalia" në dhjetor 2008 dhe nisi opera-

cionin detar "EU Navfor-Atalanta" në përgjigje të nivelit të rritjes të piraterisë dhe grabitjeve të armatosura në të ashtuquajturën zonë detare "Brirët e Afrikës". Anëtarët e marinës detare të Malit të Zi kanë marrë pjesë në operacionin "EU Navfor-Somalia" të BE-së që nga viti 2010 dhe kanë kryer detyrat e tyre në Komandën e Operacionit, si

dhe në anijet në zonën e operacionit. Marina malazeze e zgjeroi pjesëmarrjen e saj në këtë operacion në prill 2017 duke dërguar Ekipet e Pavarura të Mbrojtjes së Anijeve në anijet tregtare të angazhuara për nevojat e Programit Botëror të Ushqimit të Kombeve të Bashkuara në rajonin detar "Brirët e Afrikës".




Ushtarakët arsimohen në Akademinë Ushtarake të Italisë

Ministria e Mbrojtjes ka bërë public njoftimin për zgjedhjen e kadeteve për arsim në Akademinë Ushtarake në Republikën e Italisë. Duke filluar nga viti i studimit 2021/2022, një vend u hap në Akademinë Ushtarake të Ushtrisë, këmbësisht, në Modena.

Në fillim të arsimit në akademitë ushtarake, kandidati i përzgjedhur fiton titullin kadet dhe pas përfundimit të arsimit, ai pranohet në shërbim në Ushtrinë e Malit të Zi, pa njoftim publik, në gradën fillestare të oficerit.

Teksti i publikimit ka kushtet e përgjithshme dhe të veçanta, të drejtat dhe detyrimet e kadeteve, si dhe formularin e aplikimit i cili mund të gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, të Malit të Zi.

Të interesuarit mund të aplikojnë deri më 25 mars. Dokumentacioni i aplikimit dërgohet në adresën: Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria për Burimet Njerëzore, Çështjet e Personelit dhe Statusit, Rruga Jovana Tomaševića nr. 29, Podgorica, me shënimin "Për njoftim publik për arsimim në Akademinë Ushtarake të Ushtrisë në Republikën e Italisë".



Aplikimet për pjesëmarrje në konkurs, si dhe i gjithë grupi i dokumenteve, dorëzohen personalisht përmes strukturave të Rrethit Ushtarak Qendror (VKM) deri më 23 Prill 2021. Konkursi do të mbahet nga 21 korrik deri më 28 korrik 2021. Ai përfshin një provim në përgatitjen fizike, një test për të kontrolluar kulturën e përgjithshme të kandidatëve dhe një intervistë.



Konkursi zhvillohet në 21 korrik deri 28 korrik 2021

Forca Tokësore ka 195 pozicione të lira për ushtarakë

Aplikimet për pjesëmarrje në konkurs, si dhe i gjithë grupi i dokumenteve, duhet të dorëzohen deri më 23 prill 2021

Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Krassimir Karakachanov, është shpallur një konkurs për plotësimin e 195 pozicioneve të lira për ushtarakët në formacionet e Forcave Tokësore. Pozicionet duhet të plotësohen nga persona që kanë mbaruar shkollën e mesme civile ose të larta në vend dhe jashtë saj.

Pozicionet e njoftuara janë në formacionet e Forcave Tokësore, të vendosura në garnizonet e Stara Zagora, Yambol, Plevna, Karlovo, Kazanlak, Blagoevgrad, Vratsa, Smolyan, Svoboda dhe Musachevo.

Disa nga kërkesat për kandidatët janë: të kenë arsim të mesëm ose të lartë; që nga data e pranimit në shërbimin ushtarak, të mos jetë më i vjetër se 40 vjet, të jetë i aftë për shërbimin ushtarak; të mos jetë dënuar për një krim të qëllimshëm të një natyre të përgjithshme, pavarësisht nga rehabilitimi; të mos ketë shtetësi tjetër.

Aplikimet për pjesëmarrje në konkurs, si dhe i gjithë grupi i dokumenteve, dorëzohen personalisht përmes strukturave të Rrethit Ushtarak Qendror (VKM) deri më 23 Prill 2021. Konkursi do të mbahet nga 21 korrik deri më 28 korrik 2021. Ai përfshin një provim në përgatitjen fizike, një test për të kontrolluar kulturën e përgjithshme të kandidatëve dhe një intervistë.



Kushtet e plota të konkursit, një listë e vendeve të lira të punës, afatet dhe dokumentet e aplikimit publiko-

hen në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, seksionet "Dokumentet" - "Shpalljet dhe konkurset".

Kanë kaluar 70 vjet nga themelimi i Bazës Ajrore "Graf Ignatievo"

Baza e tretë ajrore bullgare në "Graf Ignatievo" festoi 70 vjetorin e themelimit të saj. Kjo është njësi më e madhe dhe më e gatshme për luftime e Forcave Ajrore Bullgare, pasardhëse e Regjimentit të 19-të të formuar në sistemin e integruar të mbrojtjes ajrore të NATO-s.

"Baza ajrore nuk është vetëm shtëpia e avionëve luftarakë - është një shkollë që ka ruajtur dhe azhurnuar përvojën e brezave të komandantëve, pilotëve, stafit inxhinierik dhe ndihmës që ndoqën ëndrrën për të mbajtur qiellin e pastër dhe të lirë." Këtë e deklaroi komandanti i Bazës së Tretë Ajrore, Gjeneral Brigade Nikolai Rusev, në fjalimin e tij drejtuar personelit me rastin e festës.

Gjeneral brigade Rusev vëren

kontributin e brezave të pilotëve dhe specialistëve të aviacionit gjatë shtatë dekadave të fundit, të cilëve Forca Ajrore u detyrohet ngritjes së saj nga detyra e parë luftarake në bazën ajrore deri në ditët e sotme. "Ne do të hedhim themelet e modernizimit të tij dhe do të ecim së bashku në rrugën e

ndërtimit të tij të plotë. Ne nuk do të kursejmë asnjë përpjekje dhe së bashku me zbatimin e aktiviteteve të fluturimit do të përgatisim stafin e fluturimit dhe inxhinierisë për avionët e rinj me shumë qëllime", tha komandanti i bazës ajrore Graf Ignatievo.



Flota detare po zhvillon në mënyrë aktive stërvitje luftarake

Anijet luftarake të Flotiljes bullgare dhe anijeve mbështetëse do të lundrojnë deri në 19 mars, si pjesë e planit vjetor për përgatitjen e formacioneve të anijeve.

Ekuipazhi i anijes së shpëtimit "Proteo", i vendosur në Stacionin Bazë të Varnës, do të kryejë një seri zhytjesh stërvitore. Ushtarët do të kryejnë detyra në lidhje me aktivitetet e riparimit nën ujë (saldimi, ngritja e punëve, aktivitetet nënujore me mjete pneumatike-hidraulike). Ata do të rrisin trajnimin e tyre në trajnimin mbi organizimin dhe përdorimin e mjeteve teknike për operacionet e shpëtimit. Gjatë udhëtimit stërvitor, anija, së bashku me Shërbimin Hidrografik të Marinës, do të kryejnë aktivitete për mirëmbajtjen e pajisjeve teknike të sistemit për lëvizjen e veçantë të anijeve në zonat detare të Republikës së Bullgarisë.

Ekipet e tanker-bunkerit "Akin" dhe anijes zjarrfikëse "Aheloy", të vendosura në Stacionin "Baza Burgas", do të kryejnë udhëtime, gjatë të cilave ata do të kryejnë ushtrime në manovrimin taktik dhe mbrojtjen e anijes, si dhe trajnim për të përmirësuar aftësitë e tyre: kur i japin



ndihmë një anijeje të dëmtuar (që digjet) në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me mjete të tjera të shpëtimit të urgjencës së Marinës.

Qëllimi i ushtrimeve është të konsolidojë njohuritë dhe të azhurnojë aftësitë e ekuipazheve të anijeve ndihmëse të flotiljes për t'u marrë me një gamë të gjerë situatash në shpëtimin emergjent, riparimet dhe zjarrfikjet në det.

Ushtrimet do të kryhen në ujërat territoriale Bullgare, në gjirit detare Burgas dhe Varna, të përdorura zakonisht nga Marina, pa prishur trafikun e rregullt të anijeve tregtare. Fregata "Brave" vazhdon të lundrojë jashtë vendit. Më 17 mars, fregata u ankorua në portin e Potit, Republika e Gjeorgjisë dhe u bashkua me Grupin e Dytë të Përherëshëm të Anijeve të NATO-s (SNMG2). Komandanti i anijes, kapiteni II gradë Trifon Mitishev, së bashku me komandantët e tjerë të anijeve nga SNMG2, morën pjesë në një takim me komandantin e grupit.

Elez Isufi figurë historike e politike



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ


Për Elez Isufin është shkruar dhe do të shkruhet

Në saje të detyrës dhe detyrimit që kemi përballë historisë sonë ushtarake e kombëtare, në vijimësi kemi shkruar dhe propaganduar këtë trashëgimi, që përbën dhe thesarin më të çmuar të traditave tona heroike e historike. Në procesin e pandërprerë të pasqyrimin të veprimtarisë legjendare dhe historike të figurave dhe të ngjarjeve madhore të popullit dhe të ushtrisë sonë kombëtare, Elez Isufi i përket asaj plejade figurash historike e politike, që i kuptoi gjithnjë kërkesat e shenja të popullit, interesat e larta të Atdheut dhe nevojat e domosdoshme të kombit. Kështu ai u vu në shërbim të tyre, me gjithçka munda e gjithçka pati.

Për jetën dhe veprën e Elez Isufit është shkruar dhe përshkruar me tërë madhësinë e saj. Veprën legjendare dhe portretin e tij në shumë dimensione kombëtare e ka përcaktuar shumë qartë dhe në mënyrë profesionale Prof. Hysen Kordha. Duke studiuar rreth kësaj figure kombëtare shikon me objektivitet dhe vërtetësi rolin, kontributin e çmuar të Elez Isufit në rrjedhën e ngjarjeve historikopolitike të kombit tonë. Por, portreti i tij si udhëheqës popullor, madje dhe shpirtëror, e bën atë një nga figurat më të dukshme në skemën e jetës politike shqiptare në çerekun e parë të shek. XX. Për Elez Isufin është shkruar dhe do të shkruhet. Figura e tij është shumë dimensionale dhe nuk mund të ezaurohet, pasi galeria e veprës së tij të gjithanshme ka mbetur e fiksuar në mjaft dokumente të kohës.

Duke u lidhur ngushtë me detyrat historike e politike të kohës në të cilën jetoi, me detyrat dhe etapat historike që vendi, populli dhe kombi po kalonte, Elez Isufi u radhit ndër ato personalitete e figura të rralla të historisë tonë kombëtare. Ai u ndërgjegjësu për domosdoshmërinë e përfshirjes së tij në rrjedhat e lëvizjes politike e shoqërore, dhe deri sa dha jetën e tij, qëndroi i papërkulur në llogoret e luftës. Duke luftuar dhe duke u përpjekur për të përmbushur detyrën fisnike ndaj atdheut, që në fakt diktonin para çdo atdhetari interesat e vendit e të kombit, ai i përmbushi kurdoherë me sukses. Ndaj dhe nuk pati ngjarje politike apo betejë luftarake ku dora, ndikimi dhe kontributi i tij i çmuar, të mos linte gjurmë e të ndikonte fuqishëm në ecurinë, në fatet e drejtimit e tyre. Duhet pohuar, se ai me kontributet e veta në histori, ka luajtur një rol vendimtar.

Në kuadrin e 100 vjetorit të betejave në malet e Dibrës, kundër ushtrisë serbe



Roli në historinë kombëtare, në detyrën e komandantit të ushtrisë

Në ngjarjet politike të vitit 1921, 100 vjet më parë, roli i tij në historinë kombëtare, kur për shkak të sulmeve të vijueshme serbe dhe të depërtimit të forcave të tyre në brendësi të territoreve të shtetit shqiptar, sidomos në zonat verilindore, situata u bë kërcënuese dhe me pasoja të rrezikshme, për pavarësinë dhe sovranitetin e shtetit e të popullit shqiptar. Në këtë vit u shqua roli i tij parësor me qëndresën heroike në malet e Dibrës.

Në këtë situatë të rëndë e të rrezikshme, si dhe kërcënuese për Shqipërinë, qeveria shqiptare e bindur në atdhetarizmin e shqiptarizmin e Elez Isufit, i besoi dhe i ngarkoi atij detyrën e Komandantit të Ushtrisë. Kjo ushtri e përbërë nga civilë dhe nga forca të rregullta organizoi qëndresë dhe bëri përballimin e sulmeve të vijueshme të ushtrisë serbe. Në saje të drejtimit të Isuf Elezit u organizua kundërmësimja dhe u dëbuan pushtuesit serb, jashtë kufijve politikë, duke bërë sigurimin e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar. Roli i tij në këtë periudhë ishte i përmasave kombëtare. Si qeveria shqiptare, ashtu dhe të gjitha forcat politike e shoqërore të vendit shprehën besimin e duhur dhe simpatinë për vetitë dhe cilësitë e larta të Elez Isufit. Në këtë organizim ushtarak dhe shoqëror, ai u shqua për mprehtësi dhe aftësi organizative e komanduese, u bë model i një lideri popullor, i një strategu ushtarak, duke i njohur edhe peshën e tij në jetën

politike. Atij i çmohej fjala, besa dhe e vlerësonin, ndaj dhe i dhanë në ato momente vendin dhe rolin e drejtuesit të lëvizjes e të luftës çlirimtare për dëbimin e okupatorëve serb. Ndaj dhe si gjithnjë triumfoi në misionin që drejtoi, që udhëhoqi e komandoi. Hoxha Kadriu dhe Ismail Strazimiri duke vënë në dukje këtë fakt të rëndësishëm dhe vendimtar për fatet e Shqipërisë, e vlerësonin lart rolin e Elez Isufit, për kurorëzimin me sukses të strategjisë dhe taktikës së luftës çlirimtare shqiptare antiserbe gjatë vitit 1921. Në këto kohëra serbët sulmonin gjithnjë viset Lurë, Reç, Dardhë dhe Lumë.

Elez Isufi, që në kohën e Iliaz Vrionit ishte emëruar komandanti i Ushtrisë me civilë dibranë, dhe duke luftuar kundër serbëve nuk i lejoi ata të përparonin në territorin shqiptar. Betejat që zhvilloi Elez Isufi gjatë gjithë vitit 1921, përbëjnë faqe lavdie në historinë e luftërave çlirimtare të shqiptarëve për të mbrojtur trojet e të parëve dhe për të çliruar tokat shqiptare të pushtuara nga trupat serbe.

Elez Isufi, si gjithnjë i gatshëm kur e thërriste zëri i atdheut, në krye të trupave luftarake shqiptare, jo vetëm organizoi qëndresë, por përballoi me heroizëm të pashoq sulmet e njëpasnjëshme të ushtrisë serbe, dhe projektoi e organizoi kundërmësimjen e trupave shqiptare. Në krye të trupave shqiptare, ai arriti të thyente dhe të zbrapste trupat pushtuese serbe, të cilat në rrëmujë të plotë dhe për të shpëtuar kokën u tërhoqën në panik. Elez Isufi e ndiqte me shumë kujdes e vëmendje situatën, dhe pa rënë në vetkënaqësi e

euforizëm, me mençurinë e një politikani atdhetar, me mprehtësinë e një strategu ushtarak, krahas ndjekjes së pushtuesit, në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit shqiptar, merrte në dorëzim tokat shqiptare dhe, kudo që kalonte, i prituri nga populli shqiptar si triumfator dhe shpëtimtar, merrte masa për garantimin e sukseseve dhe fitoreve të arritura në fushat e betejave.

Gjenerali popullor zë vend të veçantë

Ishin kohë të lavdishme, periudha historike, ku heroizmi masiv popullor shqiptar shkruante faqe të reja, në historinë e kombit dhe në rrugën e lirisë e të pavarësisë. Këto momente pasqyrohen edhe në një dokument, që po jua paraqesim për t'u njohur. Në mjaft dokumente të kohës evidentohet roli i jashtëzakonshëm dhe përgjegjësia e madhe e Elez Isufit në skenën e ngjarjeve politike ushtarake, e veçmas të asaj periudhe delikate e të vështirë që kalonte Shqipëria e populli shqiptar. Në librin e Ismail Strazimirit "Lufta kundër pavarësimin të Shqipërisë", gjenerali popullor, Elez Isufi zë një vend të veçantë në mjaft faqe dhe dokumente të kohës. Në këto dokumente Shqipëria dhe gjithë populli shqiptar çmonin dhe vlerësonin "gjeneralin me shajak", siç u quajt dhe mbeti në histori, kreshniku që nuk rreshti së punuari dhe luftuari për nderin e triumfin e shqiptarizmit, për çështjen e vendit dhe të kombit tonë.

Në një dokument, i cili në vetvete përbën një njoftim që Elez Isufi i dërgonte nga Luma-Bicaj, Kryeministrisë në Tiranë, me të cilën e vinte në dijeni dhe e lajmëronte mbi zhvillimin e situatave, dhe mbi të gjitha, për tërheqjen e trupave pushtuese serbe nga territoret shqiptare. Njëherazi, ai e vinte në dijeni, mbi gjithçka që e vlerësonte të nevojshme për interesat e vendit e të momentit historik. Njoftimi ka mjaft aspekte dhe pasqyron probleme të kohës. Në një njoftim që kishte marrë Elez Isufi nga komanda e ushtrisë serbe, e cila tërhiqej e mundur nga tokat shqiptare, ushtria serbe e detyruar, njoftonte Elez Isufin, sepse e njihte për kundërshtar dhe ja dinte vlerat dhe peshën e fjalës. Armiku tek ai, shikonte njërin prej kreshnikëve shqiptarë që kishte prerë njëherë e përgjithmonë vrullin synimeve të tyre shoviniste e ekspansioniste. Ai u kishte ndaluar hovin inkursioneve të tyre, dhe ikishte thënë ndal çdo sulmi, duke smbrapsur tërë ekspeditat e tyre ushtarake. Komanda serbe e lajmëronte se do të tërhiqej nga gjithë toka shqiptare brenda një afati sa më të shkurtër. Dhe kjo për herë të

parë i njoftoj botërisht Elez Isufit. Nga ky njoftim i ushtrisë armike, del qartë se ajo njihnte luftën e kreshnikut shqiptar, duke njohur mirë rolin e tij në rrjedhën e ngjarjeve historike edhe në momente kur vendosej fati i Shqipërisë.

Elez Isufi e njoftonte Kryeministrinë edhe për masat që po merrte. Në radhë të parë ai po merrte në dorëzim tokat shqiptare, deri atëhere të pushtuara nga armiqtë serb. Në dokument pasqyrohet gëzimi i papërshkruar i popullit dhe pritja madhështore, që banorët e zonave të rezervuan Elez Isufit, trimit legjendar dhe syapatrembur në krye të trupave shqiptare. Në dokument del dhe vlerësimi e ndjenja e mirënjohjes që populli i shprehte qeverisë, ku natyrisht gjente veten e vet dhe Elez Isufi që kreu detyrat e ngarkuara nga qeveria dhe shteti shqiptar. Kjo e mbushte me krenari, por edhe me detyrimin për të zgjidhur detyrat e reja që po krijoheshin për shtetin shqiptar. Ndaj dhe e vinte në dijeni qeverinë shqiptare se "mbasi të lidhim besën që kërkon nevoja e shtetit dhe e qeverisë shqiptare" do të kthehej në Dibër. Pra, vetëm pasi të përmbushte me nder deri në fund detyrat ashtu siç e kërkonin interesat e Atdheut, Elezi do të kthehej në Dibër. Bij, si Elez Isufi, që për interesat e Shqipërisë dhe të kombit shqiptar nuk kishin asnjë interes tjetër, janë të rrallë në historinë kombëtare. Çdo ushtarak dhe pjesëtar i Forcave të Armatosura duhet të krenohet dhe të frymëzohet, nga mesazhet e veprës së Elez Isufit, të shërbejnë gjithnjë si apel, për të realizuar detyrën ndaj atdheut.

Mjaft dokumente të Elez Isufit të bëjnë të mendosh, të gjykos dhe të vlerësosh. Në retrospektivë shikon fantazinë dhe veprimet e matura, të guximshme, të mënçura të Elez Isufit. Kurdoherë në krye dhe në komandë të forcave ushtarake, në zgjidhje të detyrës.

Për probleme strategjike ai e njoftonte Kryeministrinë, se nuk do të largohej nga zona pa organizuar lidhjen e besës, të cilën e shihte dhe e vlerësonte me të drejtë si një domosdoshmëri, që e diktonin dhe e kërkonin "nevojat e shtetit e të qeverisë shqiptare". A nuk është kjo një dëshmi e largpamësisë dhe e mençurisë së politikantit e atdhetarit, që dallonte në vorbullën e ngjarjeve hallkën për të zgjidhur detyrën në interes të Atdheut? Elez Isufi gjithçka e llogariste dhe e peshonte në kuadrin e interesave të shtetit dhe të kombit, ndaj populli dhe kombi e fiksuan në kujtesën kombëtare veprën e tij. Ajo është bërë pjesë e vetëdijes historike duke jua transmetuar brezave në përjetësi këto mesazhe.

Kjo është raketa Long March-7A

Kina lëshon drejt orbitës raketën e gjeneratës së re

Raketa 573 tonë metrikë, e gjatë 60,1 metra, mund të mbajë një ngarkesë me peshë nga 5,5 deri në 7 tonë

Programi hapësinor i Kinës bëri një kthim të fortë pasi lançoi në orbitë raketën e saj të gjeneratës së re. Raketa mbajtësi i përmasave të mesme të gjeneratës së re, Long March-7A, u dërgua në hapësirë në orët e para të mëngjesit të datës 12 mars 2021, një satelit për verifikimin e teknologjisë nga Qendra për Lançimin e Satelitëve në Hapësirë, Wenchang në provincën jugore Hainan. CNN shkruan se raketa është nisur drejt orbitës.

Raketa 573 tonë metrikë, e gjatë 60,1 metra, mund të mbajë një ngarkesë me peshë nga 5,5 deri në 7 tonë. Më 16 mars të vitit të kaluar, e njëjta raketë nuk arriti të ngrihej në fluturimin e saj të parë, njoftoi e përditshmja kineze "Global Times".

"Lançimi i suksesshëm i Long March 7A ka pasuruar më tej spektrin e serisë së raketave Long March, duke azhurnuar raketat e mesme bartëse të Kinës. Ajo do të drejtojë zhvillimin e satelitëve të mëdhenj dhe të mesëm", -tha Meng Gang, projektuesi kryesor i raketës.

Dështimi u shkaktua nga "humbja e presionit". Raketa përdor energji të pastër për operacionet e saj, -tha zhvilluesi i saj, Akademia Kineze e Teknologjisë së Lançimit të Mjeteve (CALT-China Academy of Launch Vehicle Technology). Do të përdoret për të monitoruar mjedisin hapësinor dhe për të testuar teknologji të tjera të përparuara. "Raketa e gjeneratës së re jo vetëm që ka zmadhuar kapacitetin e ngarkesës nga 5.5 në 7 tonë, por gjithashtu ka një shtytës më të gjelbër dhe miqësor ndaj mjedisit, vajguri i oksigjenit të lëngshëm", -tha për "Global Times", Ma Zhonghui, zëvendës shefi dizajnuar i raketës.

Pas riparimeve disa mujore, shkencëtarët kinezë më në fund



nxorën raketën që kaloi provën përfundimtare më 30 dhjetor dhe pjesët e raketës u transportuan në qendrën e lançimit në një anije mallrash të projektuar posaçërisht Yuanwang-22

në mes të janarit. Kina planifikon të përdorë raketën për të dërguar satelitë në orbitë, përfshirë sistemin satelitor të navigimit Beidou dhe sisteme të tjerë telekomunikues.

NASA shpërndan pamje të reja nga misioni në Mars

NASA ka shpërndarë disa foto të reja nga sonda "Perseverance", e cila ndodhet me mision në Mars. Sonda "Perseverance" u ul më 18 shkurt në kraterin "Jezero" për të kërkuar shenja të jetës antike mikroskopike. Sonda do t'i kalojë dy vitet e ardhshme duke eksploruar grykëderdhjen e thatë të lumit dhe duke shpuar në shkëmbinj të që mund të përmbajnë prova të jetës tre-katër miliardë vjet më parë. Mostrat kryesore do të lihen mënjanë për t'u kthyer në Tokë pas një dekade. NASA shtoi 25 kamera në misionin prej 3 miliardë dollarësh, kamerat më të shumta të dërguara ndonjëherë në Mars.



INDUSTRIA USHTARAKE TURKE

Sistemi imbrojtjes ajrore HISAR-O+ kalon testet e gjuajtjes

Raketa vendore dhe kombëtare HISAR-O+ arriti të godasë objektivin e saj në distancën më të largët dhe lartësinë më të lartë në gjuajtjen e fundit. Kreu i Departamentit të Presidencës të Industrisë së Mbrojtjes Ismail Demir raportoi se sistemi i mbrojtjes ajrore me lartësi të mesme HISAR-O+ me sukses kaloi testet e distancës më të largët dhe lartësisë më të lartë të kryera ndonjëherë në Turqi duke goditur drejtpërdrejt dhe shkatërruar objektivin e saj.

Demir postoi një mesazh në llogarinë e tij në Twitter në lidhje me testet e fundit të sistemit të mbrojtjes ajrore HISAR-O+ me lartësi të mesme. Duke tërhequr vëmendjen në qëllimin e testeve Demir tha: "Pas dorëzimit të sistemit HISAR-A+, sistemi ynë i mbrojtjes ajrore HISAR-O+ me lartësi të mesme kaloi me sukses testet e distancës më të largët dhe lartësisë më të lartë të kryera ndonjëherë në Turqi, duke goditur drejtpërdrejt dhe shkatërruar objektivin e saj. Shprehim falënderimet për të gjithë aktorët që kontribuan në këtë projekt, veçanërisht partnerëve të projektit ASELSAN dhe ROKETSAN."

Sistemi HISAR-O+ i zhvilluar nga Turqia



me mundësi kombëtare do të përdoret për të plotësuar nevojat e saj për mbrojtjen ajrore në lartësi të mesme. I zhvilluar në bashkëpunim me kompanive turke të industrisë së mbrojtjes ASELSAN, ROKETSAN dhe aktorëve të tjerë të interesuar në koordinim me departamentin e Industrisë së Mbrojtjes, sistemi do të sigurojë mbrojtje ajrore, veçanërisht për trupat stacionare dhe objektet kritike.

Sistemi synon të eliminojë kërcënimet e paraqitura nga mjete ajrore me krahë fikse dhe rrotullues, raketa kruz, mjete ajrore pa pilot dhe raketa tokë-tokë në të gjitha kushtet e motit. Sistemi HISAR-O+ mund të kryejë funksione të zbulimit, klasifikimit, diagnostikimit, përcjelljes, komandimit dhe kontrollit të zjarrit. Ky sistem gjithashtu mundëson shtimin e nevojave dhe veçorive të reja në të ardhmen me teknologjitë më të avancuara.



Efektivët e Forcës Tokësore dhurojnë gjak

